



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Komisioni Qendror i Zgjedhjeve*  
*Centralna Izborna Komisija*  
*Central Election Commission*



Prishtinë/Priština, rr./ul. Agim Ramadani tel. +381 (0) 38 551 679; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

## INFORMATË

### 1. 10. 2009

Në selinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sot në orën 11.00 është bërë ceremonia e nënshkrimit të Marrëveshjes për Mbështetje Teknike dhe Profesionale në mes të KQZ-së dhe USAID-it. Marrëveshja është nënshkruar në mes të Kryetares së KQZ znj. Nesrin Lushta dhe znj. Patricia Rader, udhëheqëse e Misionit të USAID-it në Kosovë.

Në fjalën e rastit, Kryetarja e KQZ Nesrin Lushta, tha se kjo është një ditë me rëndësi të madhe për KQZ-në. “Komisioni Qendror i Zgjedhjeve po punon sipas planit të punës dhe kjo marrëveshje me USAID-in, do të ofrojë ndihmë të madhe teknike dhe profesionale, ndihmë dhe mbështetje për procesin e zgjedhjeve. Kemi bashkpunuar edhe në të kaluarën dhe, unë besoj që do të jetë edhe në të ardhmen kështu. Me këtë marrëveshje, ne edhe më tepër me seriozitet dhe përkushtim do t’i kryejmë detyrat dhe obligimet që na takojnë”, ka thënë kryetarja Lushta.

“Jemi të kënaqur që e ndihmojmë Republikën e Kosovës, duke siguruar mbështetje në ndërtimin e kapaciteteve profesionale. Ne do të ofrojmë mbështetje, IFES si organizatë implementuese e USAID-it, do të sigurojë përkrahje teknike për KQZ-në përmes një spektri të gjërë të iniciativave në edukim, në qendra të numërimit dhe të rezultateve, në përkrahjen e fushatës për media në KQZ, si dhe në mbajtjen e zgjedhjeve efikase dhe transparente”, ka thënë znj. Patricia Rader, udhëheqëse e USAID-it.